



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Detezuar Puniljena / Prodada Received / Delivered	06.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shënjica Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKENDERAJT	3291/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.446/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.446/2022 të datës 11.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/Komunës së Skenderajt, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.446/2022 e datës 11.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Komuna e Skenderajt, zyra e kryetarit me vendimin e datës 17.01.2022 ka lejuar shpalljen e konkursit për vendet e lira të punës ku njëra prej pozitave të lejuara ka qenë edhe pozita “Specialist të Përgjithshëm të Trashëgimisë Kulturore”, i cili konkurs është shpallur më datë 19/01/2022 me afat aplikimi nga data 09.02.2022-23.02.2022 me nr.reference RN00008114. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili nga Njësia e Burimeve Njerëzore është përfshirë në listën e shkurtër dhe i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka marr 69 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt më datë 26.04.2022 ka publikuar njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues për “Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore”, në bazë të cilit njoftim ankuesi është kandidatë që ka marr 69 pikë, rrjedhimisht nuk është kandidat fitues.

Ankuesi përmes e-mailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës e cila më datë 11.05.2022 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.446/2022 dhe Nr. Prot: 2691/2022, me pretendimet ankimore kundër komisionit të vlerësimit për konkursin "Specialist i Përgjithshëm i Trashëgimisë Kulturore" në Komunën e Skenderajt.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 19.05.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Skenderajt, ndërsa Këshilli ka pranuar shkresat e lëndës nga organi i punësimit me datën 02.06.2022 me numër protokoli 3219.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot.:2691/2022 të datës 11.05.2022 e parashtruar nga ankuesi përmes e-mailit zyrtar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet e vlerësimit për pozitën "Specialist të përgjithshëm të trashëgimisë kulturore" të datës 22.04.2022; foto që nuk janë prova për shqyrtimin e ankesës; E-mail zyrtar i datës 29.04.2022; E-mail zyrtar i datës 28.04.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 02.06.2022 me numër protokoli 3219 bashkë me shkresat e lëndës ; Vendimi mbi emërimin e anëtarëve të Komisionit i datës 15.03.2022; Kërkesa për zhvillim të procedurave të rekrutimit e datës 13.01.2022; Vendimi i datës 17.01.2022 me nr.02-111/01-0002739/22 mbi lejimin e shpalljes së konkursit për vendet e lira të punës; Kopja e konkursit për pozitën "Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore"; Lista e aplikantëve; Njoftimi i datës 08.03.2022; Procesverbal i datës 21.04.2022 gjatë intervistës me gojë; Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën Specialist i përgjithshëm i trashëgimisë kulturore ; Rezultatet e vlerësimit për pozitën Specialist i përgjithshëm për trashëgimi kulturore i datës 26.04.2022 me nr.02-112/01-008437/22; kopja e letërnjoftimit; Vërtetim i datës 22.11.2021 mbi përvojën e punës; Diploma e datës 11.07.2014 me nr.3287 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Kopja e letërnjoftimit; Diploma e datës 05.09.2019 me nr.6654 e lëshuar nga Fakulteti Filozofik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"; Çertifikatë e datës 08.02.2017; Çertifikatë e datës 02.02.2018; Kontratë pune për punë dhe detyra specifike e datës 01.10.2016-01.08.2017; Marrëveshje për shërbime të veqanta nga data 24.06.2019; Marrëveshje për shërbime të veqanta e datës 08.10.2018 -28.02.2019; Letër rekomandimi dhe Dëshmi e datës 10.02.2022; Letër reference e datës 14.02.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komuna e Skenderajt më datë 22.04.2022 ka publikuar njoftimin përfundimtar me nr.02-111/01-0018186/22 për kandidatin fitues për "Specialist i Përgjithshëm për Trashëgimi Kulturore", në bazë të të cilit ankuesi nuk është kandidatë që ka marr 70 pikë, rrjedhimisht nuk është kandidat fitues.

Ankuesi kundër këtij procesi të pranimit nuk ka sjell asnjë dëshmi me të cilën dëshmohet që kundër këtij procesi ka bërë ankesë të brendshme një njësinë përgjegjëse siç parashihet me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: **"Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund**

të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual", ndërsa ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj siç parashihet me paragrafin 6 të këtij neni.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet",* si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, përveç kësaj ankuesi edhe në përmbajtje të ankesës e ka konfirmuar se nuk ka shtjerrë mjetet e brendshme, atëherë sipas Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankesave, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe",* dhe mbi këtë bazë të specifikuar më lartë ankesa e ankuesit është e palejuar.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.446/2022, datë 06/06/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

